

Regjistrat e Biznesit

Metadata Referenciale në format ESS Standard for Quality Reports
Structure (ESQRS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Paraqitja statistikore.....	2
3. Përpunimi statistikor.....	4
4. Manaxhimi i cilësisë.....	5
5. Rëndësia.....	5
6. Saktësia dhe besueshmëria.....	7
7. Afatet kohore dhe përpikmëria.....	9
8. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	10
9. Aksesit në të dhëna dhe qartësia.....	11
10. Kostoja dhe ngarkesa.....	12
11. Konfidencialiteti.....	12
12. Komente.....	13
Aneks.....	13

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Flutura Rama
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës, Sektori i Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	frama@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Paraqitja statistikore	
2.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Regjistrat e biznesit (RB) shërbejnë për qëllime statistikore dhe identifikojnë qartësisht njësitë ekonomike, në mënyrë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të lejojnë marrjen e informacionit për to nëpërmjet burimeve administrative; • Të lejojnë përgatitjen e kampionëve, koordinimin e anketave dhe për grupimin e rezultateve të tyre; • Të lejojnë analizën demografike të popullsisë së ndërmarrjeve dhe njërive lidhur me to. RSN është bazë për hartimin e statistikave të nevojshme për dhënien e treguesve afat-shkurtër dhe të zhvillimeve strukturore ekonomike. <p>RB përmbajnë të gjitha njësitë ligjore regjistruar pranë sporteleve të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) apo edhe pranë Organeve Tatimore. Këto njësi janë të pajisura me Numër Identifikimi të Personit të Tatuashëm (NIPT) dhe ushtrojnë aktivitet ekonomik brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. RB përditësohen nga burime administrative dhe vrojtime statistikore të organizuara nga INSTAT.</p>
2.2. Sistemi i klasifikimit	<p>Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE), është klasifikim në nivel katërshifror i veprimtarive ekonomike të ushtruara nga ndërmarrjet. Kjo nomenklaturë është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 320 datë 28.5.2014 dhe është përkthimi dhe përshtatja e Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike të Komunitetit Evropian NACE Rev.2. Madhësia e ndërmarrjes përcaktohet nga numri i të punësuarve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërmarrjet me 1-4 të punësuar klasifikohen si ndërmarrje shumë të vogla; • Ndërmarrjet me 5-9 të punësuar klasifikohen si ndërmarrje të vogla; • Ndërmarrjet me 10-49 të punësuar klasifikohen si ndërmarrje të mesme; • Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar klasifikohen si ndërmarrje të mëdha.

	<p>Ndarja territoriale statistikore në 3 (tri) rajone NUTS</p> <p>Organizimi territorial statistikor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë përfshin tri rajone bazuar në 12 qarqe:</p> <p>Rajoni I: Dibër, Durrës, Kukës, Lezhë, Shkodër;</p> <p>Rajoni II: Elbasan, Tiranë;</p> <p>Rajoni III: Berat, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Vlorë.</p>
2.3. Mbulimi i sektorit	<p>Regjistrat e biznesit përmbajnë të gjitha njësitë ligjore, ndërmarrjet dhe njësitë lokale që ushtrojnë aktivitet ekonomik brenda territorit të Shqipërisë. Regjistrat mirëmbajnë dhe përditësojnë informacionin si për njësitë aktive ashtu edhe për ato të fjetura apo të mbyllura.</p>
2.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Njësia ligjore</p> <p>Njësia ligjore nuk është direkt njësi statistikore. Njësia ligjore mund të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Person juridik, ekzistenca e të cilit njihet nga ligji, pavarësisht nga individët apo institucionet që mund ta zotërojnë apo janë anëtarë në të. • Person fizik i angazhuar në një aktivitet ekonomik në të drejtën e tij. <p>Ndërmarrja</p> <p>Ndërmarrja është: “kombinimi më i vogël i njësive ligjore pra një njësi organizative e cila prodhon të mira apo shërbime dhe ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale). Marrëdhënia mes një ndërmarrje dhe një njësie ligjore përkufizohet si: “ndërmarrja i korrespondon ose një njësie ligjore ose një kombinimi njësisish ligjore”.</p> <p>Njësia lokale</p> <p>Njësia lokale është një ndërmarrje apo pjesë e saj (p.sh. manifakturë, fabrikë, magazinë, zyrë, minierë apo depo) të ndodhura në zona të identifikuar gjeografikisht. Tek ky apo nga ky vend ushtrohet aktiviteti ekonomik për të cilin me përjashtim të disa rasteve punojnë një ose më shumë persona (edhe pse me kohë të reduktuar) për një ndërmarrje të vetme.</p> <p>Aktiviteti ekonomik</p> <p>Aktiviteti ekonomik I ndërmarrjes bazohet në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev.2.</p>
2.5. Njësia statistikore	<p>RB përmbajnë njësitë statistikore: Ndërmarrja dhe Njësia Lokale.</p>
2.6. Popullata statistikore	<p>Popullata statistikore përfshin ndërmarrjet aktive, të fjetura ose të mbyllura në fund të vitit referencë.</p>
2.7. Zona e referencës	<p>Të dhënat e Regjistrave të biznesit mbulojnë të gjithë territorin e Shqipërisë.</p>
2.8. Mbulimi në kohë	<p>INSTAT ndërtoi për herë të parë Regjistrin Administrativ të Bizneseve në vitin 1994, dhe prej vitit 1998 përditëson dhe mirëmban Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve, ndryshe RSN. Ky regjistër u ndërtua dhe bazohet në të dhëna administrative të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT). Që prej vitit 2007 regjistri përditësohet gjithashtu me të dhëna nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).</p> <p>Në vitin 2010 u ndërtua regjistri i njësive lokale dhe në vitin 2017 regjistri i</p>

	grupeve të ndërmarrjeve.
2.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet vit bazë. Ky raport i referohet të dhënave të RB 2021.
3. Përpunimi statistikor	
3.1. Burimi i të dhënave	<p>Regjistrat e biznesit me vit referencë 2021 përditësohen nga:</p> <p>Burime administrative të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacioni nga Qendra Kombëtare e Biznesit(QKB); • Informacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve(DPT); • Skedari i TVSH-së; • Llogaritë vjetore të ndërmarrjeve. <p>Burimet statistikore të kryera nga INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, ASN; • Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve, ATN; • Anketa e Çmimeve të Prodhimit, IÇP; • Anketa të tjera
3.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	<p>Regjistrat e biznesit përditësohen një herë në vit dhe shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qendra Kombëtare e Biznesit(QKB) - vjetore; • Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve(DPT) - tre-mujore; • Llogaritë vjetore të ndërmarrjeve vjetore; • Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, ASN - vjetore; • Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve, ATN - tre-mujore; • Anketa e Çmimeve të Prodhimit, IÇP - vjetore;
3.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Të dhënat e grumbulluara nga burimi administrativ janë burimi më i rëndësishëm për të përditësuar RB. Burimet administrative krijojnë mundësinë e përfshirjes së njësive ligjore të reja, ashtu edhe për të identifikuar ndryshimet për çdo variabël në nivel ndërmarrje. Burimet statistikore përdoren nga sektori i RSN në momentin që ato finalizohen. Sektori bazuar në një listë të prioriteteve për çdo burim realizon përditësimin e RB. Lista e prioriteteve përgatitet bazuar në: Periudha referencë dhe rëndësia.</p>
3.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Sa i përket vlefshmërisë së të dhënave, procedurat e editimit të të dhënave në përgjithësi i referohen editimit në nivel mikro ose ndryshe në nivel ndërmarrje apo njësi lokale. Kontrollat e kryera bazohen kryesisht në përputhshmërinë me klasifikimet evropiane dhe kombëtare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • NVE Rev.2; • Forma ligjore; • Pronësia Shtetet; • Bashkia; • Qarku. <p>Kontrolle manuale bëhen për ndërmarrjet e mëdha dhe për ndërmarrjet në degë strategjike si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Transporti hekurudhor;

	<ul style="list-style-type: none"> • Transporti ajror; • Aktivitete postare dhe të korrierës; • Prodhimi i energjisë elektrike; • Administrata publike. • Të tjera. <p>Aktiviteti ekonomik i tyre është miratuar nga grupi i përdoruesve të RB, i cili merr në shqyrtim dhe vendos në rastet e paraqitjes së ndryshimit të aktivitetit ekonomik për çdo njësi statistikore</p>
3.5. Përpilimi i të dhënave	<p>Krijimi i njësive ligjore të reja automatikisht çon në krijimin e një ndërmarrjeje dhe një njësie lokale të re me variablat e RSN. Ky informacion sikurse dhe ndryshimet përftohen nga burimi administrativ, kryesisht DPT. Informacioni në nivel ndërmarrje përditësohet nga vrojtimitet e ndryshme sipas listës së prioriteteve dhe periudhës referencë të burimit administrativ apo statistikor. Për ndërmarrjet e mëdha bëhen përditësime manuale edhe nga kërkimet në internet. Vetëm sektori i RSN ka të drejtë të bëjë ndryshime. Sektorët e tjerë të INSTAT dërgojnë të dhënat në nivel ndërmarrje nga vrojtimitet apo ndryshime të tjera.</p>
3.6. Rregullimi	<p>Nuk aplikohet. Asnjë rregullim nuk i bëhet të dhënave të grumbulluara nga RSN.</p>
4. Manaxhimi i cilësisë	
4.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr.17/2018, datë 05.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
4.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Të dhënat e RB krahasohen me të dhënat e RB në vitet e mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha. Në rastet e ndryshimeve përdoren të dhënat administrative/vrojtimitet statistikore për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen diferenca të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.</p>
5. Rëndësia	
5.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e RB ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucione të administratës publike • Universitetet • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare

	<ul style="list-style-type: none"> • Bizneset • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. <p>Botimi Regjistrat e biznesit i dërgohet çdo vit në një grup të caktuar përdoruesish. Gjithashtu plotësohen pyetësorë të dedikuar nga institucionet ndërkombëtare si Eurostat, Zyra Statistike e Bashkimit Evropian dhe Banka Botërore. Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin të dhënat e RB si input në punën e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sektorët nga Drejtoria e Llogarive Kombëtare • Sektori i Metodologjisë • Sektori i Indekseve (veçanërisht për përditësimin e skedarit të TVSH-së me klasifikimin NACE) • Drejtoria e Statistikave Rajonale • Drejtoria e Statistikave Sociale • Zyrat Rajonale të Statistikave
5.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Pyetjes: "Si e vlerësoni cilësinë e përgjithshme të statistikave të Regjistratit Statistikor të Ndërmarrjeve?" në shkallën nga 1 tek 5 (1=shumë e dobët, 2=e dobët, 3=e përshtatshme, 4=e mirë, 5=shumë e mirë), përdoruesit kanë vlerësuar cilësinë e të dhënave me një mesatare prej 3.50 (70.0%).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</p>
5.3. Plotshmëria	<p>Për prodhimin e të dhënave statistikore të RSN ndiqet kjo bazë ligjore. Këto baza ligjore sigurojnë që të gjitha ndërmarrjet që operojnë në Shqipëri janë të detyruara të regjistrohen në DPT dhe DPT duhet të kalojë informacionin e nevojshëm për RSN në INSTAT.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 17/2018 datë 5.04.2018 "Për statistikat zyrtare" i ndryshuar; • Rregullorja e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (BE) 2019/2152 e datës 27 nëntor 2019, mbi "Statistikat Evropiane të Biznesit"; • Ligji nr. 30/2022 datë 24.03.2022 "Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026"; • Vendim i Këshillit të Ministrave për "Për miratimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të revizionuar (Rev. 2)" Nr. 320 datë 28.5.2014; • Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe INSTAT, datë 11.3.2015; • Ligji Nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"; • Ligj nr. 43/2022 datë 21.04.2022 "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme"; • Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1037, datë 15.12.2010. "Për zbatimin e nomenklaturës "Shqipëria në 3 (Tri) Rajone NUTS II", sipas nomenklaturës së njësisve territoriale për statistikën (NUTS), të Bashkimit Evropian; • Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 19 datë 3.11.2014 "Për Zbatimin e Regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për 7 qëllime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar". <p>Përveç kësaj baze ligjore ekziston një shkëmbim i të dhënave me QKB.</p>

5.3.1. Plotshmëria e të dhënave - shkalla e plotshmërisë së të dhënave	Shkalla e plotshmërisë të të dhënave, për SBR 2021, është 100%. Kjo përlllogaritje ka marrë në konsideratë të dhënat që kërkohen nga EUROSTAT, Rregullorja e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (BE) 2019/2152 e datës 27 nëntor 2019, mbi “Statistikat Evropiane të Biznesit.
6. Saktësia dhe besueshmëria	
6.1. Saktësia e përgjithshme	Të dhënat e vitit referencë krahasohen me të dhënat e viteve më parë për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha. Në rastet e ndryshimeve përdoren të dhënat administrative për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen diferenca të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.
6.2. Gabim i kampionimit	Nuk ka gabim kampionimi pasi ky nuk është një vrojtim statistikor i mirëfilltë por një integrim i të dhënave statistikore me ato administrative.
6.2.1. Gabimet në kampionim - indikatorët	Nuk është e aplikueshme pasi është burim administrativ.
6.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Gabimet jo të kampionimit në thelb janë të 4 llojeve:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gabimet e mbulimit: gabimet për shkak të divergjencave ekzistuese midis popullatës së synuar dhe kornizës bazë të kampionimit. 2. Gabimet e matjes: gabimet që ndodhin në kohën e mbledhjes së të dhënave. Ekzistojnë një numër burimesh për këto gabime siç janë instrumenti i anketës, sistemi i informacionit, intervistuesi dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave. 3. Gabimet e përpunimit: gabimet në proceset pas mbledhjes së të dhënave si futja e të dhënave në program, editimi dhe peshimi. 4. Gabimet e mospërgjigjes: gabime për shkak të një përpjekje të pasuksesshme për të marrë informacionin e dëshiruar nga një njësi e pranueshme. <p>Në lidhje me RB nuk ka gabime në kampionim, pasi përfshihet gjithë popullata e njësive ligjore, e ndërmarrjeve dhe e njësive lokale.</p> <p>Në Shqipëri nuk ekziston ende sistemi i adresave dhe kjo sjell një cilësi jo të mirë të adresave në nivel ndërmarrjeve. Anketuesit e theksojnë gjithmonë këtë problem në terren sidomos më ndërmarrjet e vogla. Procesi i përditësimit ka edhe procedura automatike kontrolli si për shembull kontrolli i gabimeve në NVE Për të kontrolluar përputhshmërinë e NVE me përshkrimin me fjalë kontrollet manuale bëhen vetëm për ndërmarrjet e mëdha. Megjithatë bashkëpunimi më burimet administrative është shumë i rëndësishëm për të siguruar plotëshmërinë ashtu edhe për të rritur cilësinë e regjistrave, si bazë për prodhimin e statistikave.</p> <p>Cilësia e të dhënave të ndërmarrjeve është më e lartë se cilësia e të dhënave të njësive lokale, pasi nuk ka një burim administrativ i cili të përditësojë të dhënat e njësive lokale. Regjistri i njësive lokale nuk identifikon njësitë e reja të krijuara gjatë një viti, sikurse edhe mjësitë e mbyllura apo të pezullurara përkohësisht</p>

6.3.1. Gabimi në mbulim	Mbi-mbulimi ndodh kur ndërmarrja e zgjedhur në RB është aktive por gjatë procesit të intervistimit ajo nuk është më aktive, është e mbyllur ose është e pamundur të gjendet.
6.3.1.1. Shkalla e mbi-mbulimit	Shkalla e mbi-mbulimit për RSN 2021, duke marrë në konsiderate dy nga anketat më të rëndësishme që kryen INSTAT, Anketën Strukturore të Ndërmarrjeve si dhe Anketën Tremujore të Ndërmarrjeve, është 2.86%.
6.3.1.2. Pjesa e njësive që mbulohet edhe nga anketa edhe nga burimi administrativ	Nuk aplikohet. Nuk mund të llogaritet pasi ky nuk është një vrojtim statistikor i mirëfilltë.
6.3.2. Gabimi në matje	Në INSTAT funksionon grupi i përdoruesve të regjistrave të biznesit , prej vitit 2018. Anëtarë të grupit diskutojnë problematikat dhe planin e aktiviteteve për të pasur regjistra të biznesit të përditësuar dhe cilësorë. Sektori i RSN ka përgatitur një listë me ndërmarrje të mëdha dhe me ndërmarrje në degë strategjike të ekonomisë, ku aktiviteti kryesor i tyre (NVE 4 shifrore) është miratuar nga të gjithë anëtarët. Këto ndërmarrjeve trajtohen në të njëjtin aktivitet ekonomik, në të gjitha vrojtimit apo gjatë procesit të prodhimit të statistikave ekonomike dhe makro-ekonomike, duke bërë të mundur shmangien e gabimeve në matje.
6.3.3. Gabimi në mos-përgjigje	Nuk ka gabim mos-përgjigje pasi RSN mbulon të gjitha njësitë legale, ndërmarrjet dhe njësitë lokale që kryejnë aktivitet ekonomik në territorin e Shqipërisë.
6.3.3.1. Shkalla e mos-përgjigjes së njësive	Nuk aplikohet. Nuk ka shkallë për mos-përgjigje të njësive pasi ky nuk është një vrojtim statistikor i mirëfilltë.
6.3.3.2. Mos-përgjigja në nivel variabli	Nuk aplikohet. Mos-përgjigja në nivel variabli nuk ekziston pasi ky nuk është një vrojtim statistikor i mirëfilltë.
6.3.4. Gabimi në procesim	Nuk ka gabime në procesim pasi përditësimi i RSN bëhet në mënyrë gjysmë automatike.
6.3.4.1. Shkalla e Imputimit	<p>Grupi i treguesve që u shqyrtua për të bërë vlerësimin e efekteve të procedurës së pastrimit në nivel të agreguar, mund të përmblihet në tre tregues të ndryshëm.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Treguesit për sasinë e të dhënave që i nënshtrohen procedurës së imputimit si: numri i rekordeve, numri i variablave, numri i variablave objekt i procedurës së imputimit dhe numri i vlerave totale. 2. Treguesit për vlerësimin e efekteve të përgjithshme të procedurës së imputimit, si: i) shkalla e imputimit1 (I): (numri i vlerave të imputuara/numri i vlerave totale)*100; ii) shkalla e shtimit (Ia): (numri I shtimeve/ numri i vlerave totale)*100; iii) shkalla e ndryshimeve (Im): (numri i ndryshimeve/numri i vlerave totale)*100; iv) shkalla e eliminimit (Ie): (numri i eliminimeve/numri i vlerave totale)*100 3. Treguesit sintetikë për shkallën e imputimeve të rekordeve, për shembull: Numri i rekordeve me shkallë imputimi më të madhe sesa 2% dhe numri i rekordeve me shkallë imputimi më të madhe sesa 5%. Në tabelën e

	<p>mëposhtme janë vlerësimet e procedurës së imputimit</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Indikatorët</th> <th>2021</th> </tr> <tr> <th>2020</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Numri i rekordeve</td> <td>434,564</td> </tr> <tr> <td>Numri i variablave</td> <td>14</td> </tr> <tr> <td>Numri i vlerave totale</td> <td>6,083,896</td> </tr> <tr> <td>Numri i vlerave të vlefshme</td> <td>6,083,896</td> </tr> <tr> <td>Numri i vlerave të vlefshme boshe</td> <td>1,200,961</td> </tr> <tr> <td>Numri i vlerave të vlefshme jo boshe</td> <td>4,882,935</td> </tr> <tr> <td>Numri i vlerave të imputuara</td> <td>496,616</td> </tr> <tr> <td>Numri i shtimeve</td> <td>295,497</td> </tr> <tr> <td>Numri i eliminimeve</td> <td>32,146</td> </tr> <tr> <td>Numri i ndryshimeve</td> <td>169,385</td> </tr> <tr> <td>Shkalla e imputimit (I)</td> <td>12.05</td> </tr> <tr> <td>Shkalla e shtimeve (Ia)</td> <td>7.17</td> </tr> <tr> <td>Shkalla e eliminimit (Ie)</td> <td>0.78</td> </tr> <tr> <td>Shkalla e ndryshimeve (Im)</td> <td>4.11</td> </tr> <tr> <td>Shkalla e mos-imputimit</td> <td>87.95</td> </tr> </tbody> </table>	Indikatorët	2021	2020	Numri i rekordeve	434,564	Numri i variablave	14	Numri i vlerave totale	6,083,896	Numri i vlerave të vlefshme	6,083,896	Numri i vlerave të vlefshme boshe	1,200,961	Numri i vlerave të vlefshme jo boshe	4,882,935	Numri i vlerave të imputuara	496,616	Numri i shtimeve	295,497	Numri i eliminimeve	32,146	Numri i ndryshimeve	169,385	Shkalla e imputimit (I)	12.05	Shkalla e shtimeve (Ia)	7.17	Shkalla e eliminimit (Ie)	0.78	Shkalla e ndryshimeve (Im)	4.11	Shkalla e mos-imputimit	87.95
Indikatorët	2021																																	
	2020																																	
Numri i rekordeve	434,564																																	
Numri i variablave	14																																	
Numri i vlerave totale	6,083,896																																	
Numri i vlerave të vlefshme	6,083,896																																	
Numri i vlerave të vlefshme boshe	1,200,961																																	
Numri i vlerave të vlefshme jo boshe	4,882,935																																	
Numri i vlerave të imputuara	496,616																																	
Numri i shtimeve	295,497																																	
Numri i eliminimeve	32,146																																	
Numri i ndryshimeve	169,385																																	
Shkalla e imputimit (I)	12.05																																	
Shkalla e shtimeve (Ia)	7.17																																	
Shkalla e eliminimit (Ie)	0.78																																	
Shkalla e ndryshimeve (Im)	4.11																																	
Shkalla e mos-imputimit	87.95																																	
6.3.5. Shkalla e gabimit në modelin e parashikuar për vlerësim	Nuk aplikohet. Nuk përdoret asnjë model për te parashikuar/vlerësuar rezultatet.																																	
6.4. Rregullimi stinor	Nuk aplikohet. Asnjë përshtatje sezonale nuk i bëhet të dhënave të grumbulluara nga RSN.																																	
6.5. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të RSN bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e Revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve 																																	
6.6. Praktika e rishikimit	Nuk aplikohen praktika rishikimi.																																	
6.6.1. Rishikimi i të dhënave - madhësia mesatare	Nuk aplikohet.																																	
7. Afatet kohore dhe përpikmëria																																		
7.1. Afatet kohore	<p>Të dhënat e Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve publikohen 5 muaj pas përfundimit të vitit referencë (T+ 152 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve 2021 është 31 Dhjetori 2021.</p> <table border="1"> <tbody> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>6/1/2022</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>152</td> </tr> </tbody> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e publikimit	6/1/2022	Afatet kohore	152																											
Periudha referuese	12/31/2021																																	
Data e publikimit	6/1/2022																																	
Afatet kohore	152																																	
7.1.1. Publikimi i rezultateve fillestare	Nuk është e Aplikueshme pasi aktiviteti publikon rezultatet finale																																	

7.1.2. Publikimi i rezultateve finale	Rezultatet e botimit të RSN publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve, i cili publikohet në faqen e internetit të INSTAT çdo vit.								
7.2. Përpikmëria	<p>Publikimi i RSN ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1" data-bbox="512 353 948 501"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>6/1/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>6/1/2022</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e shpallur	6/1/2022	Data e publikimit	6/1/2022	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2021								
Data e shpallur	6/1/2022								
Data e publikimit	6/1/2022								
Vonesa në kohë	0								
7.2.1. Përpikmëria - shpërndarja dhe publikimi	Bazuar në këtë kalendar publikimi i RB ka qenë i përpiktë në kohë, në 100% të publikimeve të kryera gjatë viteve.								
8. Koherenca dhe Krahasueshmëria									
8.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>INSTAT përdor aspektet metodologjike të cilat janë të bazuara në konceptet, përkufizimet dhe udhëzimet e Rregullores së Parlamentit dhe Këshillit Evropian (BE) 2019/2152 e datës 27 nëntor 2019, mbi “Statistikat Evropiane të Biznesit;</p> <p>Të dhënat e Shqipërisë mund të jenë të krahasueshme me vendet e BE apo vendet candidate. Në lidhje me periudhën referuese, Shqipëria përdor vitin kalendarik.</p> <p>Klasifikimi i ndërmarrjeve bëhet në bazë të Klasifikimit të Veprimtarive Ekonomike, Nve Rev.2 sipas Rregullores (KE) Nr 1893/2006 për "Zbatimin e Nve Rev. 2 në statistikave strukturore të ndërmarrjeve".</p> <p>Organizimi territorial statistikor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë përfshin tri rajone bazuar në 12 qarqe:</p> <p>Rajoni I: Dibër, Durrës, Kukës, Lezhë, Shkodër;</p> <p>Rajoni II: Elbasan, Tiranë;</p> <p>Rajoni III: Berat, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Vlorë</p>								
8.1.1. Asimetria e pasqyrës rrjedhëse së statistikave - koeficient	Nuk plotësohet nga INSTAT, llogaritet nga EUROSTAT kur të publikohen metadatat.								
8.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Procesi i aplikimit të kodit NACE Rev.2 në RSN ka filluar që në 2009. Për të bërë të mundur këtë proces në RSN u shtua një ndryshore e re e cila përfaqëson përshkrimin e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes. Kjo ndryshore u përdor si burim për përditësimin e kodifikimit NACE Rev1.1 e si pasojë dhe kodifikimin e NACE Rev.2. Këto dy procedura u zhvilluan në mënyrë paralele. Censusi i Ndërmarrjeve Ekonomike (Jo-Bujqësore) i cili u zhvillua në 2010 mundësoi përmirësimin e cilësisë së RSN edhe në kuadrin e kodifikimit NACE. Që nga ky moment filloi aplikimi i kodifikimit të dyfishtë të aktivitetit ekonomik (Nace Rev.1.1 dhe Nace Rev.2). Aplikimi i kodifikimit Rev.2 u realizua edhe për vitet 2005-2009 Ligji Nr. 115/2014. Ligji “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësisive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” u zbatuar në RSN 2015, sikurse është përgatitur seria kohore për RSN finalë për</p>								

	<p>vitet 2010-2014.</p> <p>Pra INSTAT prodhon statistika zyrtare nga RSN me ndarjen e re administrative.</p>
8.2.1. Gjatësia e serive kohore të krahasueshme	<p>Seria kohore e RB ekziston që nga viti 1998(si vit reference).</p> <p>Bazuar në NVE Rev1.1 klasifikimi i të dhënave RSN janë të krahasueshme me kalimin e viteve 1998 deri në 2014 duke mundësuar një krahasueshmëri në seri kohore prej 17 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=17).</p> <p>Në NVE Rev.2 të dhënave e RSN janë siguruar nga viti 2005 e në vazhdim duke mundësuar një krahasueshmëri në seri kohore prej 17 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=17).</p>
8.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	<p>Regjistrit e biznesit shërbejnë për prodhimin e statistikave ekonomike. Të dhënave e publikuara nga RB mund të gjenden në këto fusha të ndërlidhura: statistikat afatshkurtra, statistikat strukturore etj. Pavarësisht ngjashmërisë të treguesve të prodhuar nga këto fusha, duhet theksuar se dallime metodologjike ekzistojnë mes të dhënave të RB dhe të dhënave nga statistikat e tjera.</p>
8.4. Koherenca e të dhënave me frekuenca të ndryshme mbledhjeje	<p>RSB përdorin burime të ndryshme me frekuenca të ndryshme. Për përditësimin e RB është krijuar një listë prioritesh bazuar në periudhën referenciale të të dhënave.</p>
8.5. Koherenca - Llogaritë Kombëtare	<p>Nuk aplikohet</p>
8.6. Koherenca e brendshme	<p>Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri të tyre.</p>
9. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	
9.1. Njoftim për media	<p>Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë, numri i ndërmarrjeve, aktiviteti ekonomik, madhësisë së ndërmarrjes, pronësisë dhe shpërndarjes gjeografike. Formatit i njoftimit për shtyp ka ndryshuar; ajo është përcaktuar nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i RB publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.</p>
9.2. Publikime	<p>Rezultatet e RB janë të botuara në Vjetarin Statistikor. Përdoruesit mund të gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrat e biznesit • Vjetari Statistikor • Vjetari Rajonal statistikor • Burra dhe Gra
9.3. Baza e të dhënave on-line	<p>Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e RB nga viti 2010 si viti referenciale. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: Databaza</p>

9.3.1. Tabelat me të dhëna - Konsultimet	Klikimet (Page Views) në lidhje me Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve për vitin 2021 janë rreth 11,662 klikime ndërsa për vitin 2020 kanë qënë 9,519 klikime.
9.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat e RB nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 5 e ligjit nr 17/2018 „Për statistikatat zyrtare”.
9.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linku më poshtë: Kërko të dhëna
9.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodologjinë mbi regjistrin statistikor .
9.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e RB për qëllime të brendshme.
9.7.1. Shkalla e plotësisë së metadata-ve	Nuk plotësohet nga INSTAT, llogaritet nga EUROSTAT kur të publikohen metadatat.
9.7.2. Metadata - Konsultimet	Nuk aplikohet.
10. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Numri i stafit të përfshirë në të dhënat e RB:</p> <p>Totali: 3 të punësuar</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjegjës Sektori: 1 i punësuar • Specialistë: 1 të punësuar • Kontrollorë: 1 i punësuar <p>Për procesin e imputimit RB përdor të dhënat administrative dhe nuk ka kosto shtesë për trajtimin e mos përgjigjes. Marrëveshjet e bashkëpunimit midis INSTAT dhe DPT ose QKB konfirmojnë që të dhënat transmetohen pa kosto. Të dhënat statistikore gjithashtu janë pa kosto për RB. Staf i RSN bën kontrollin dhe përpunimin e të dhënave për rezultatin final.</p>
11. Konfidencialiteti	
11.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga INSTAT konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i Ligjit për Statistikat Zyrtare, përcakton qartë se i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose publikohet vetëm në tabela përmbledhëse, për të mos identifikuar njësinë burimore të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore

	<p>identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p> <p>Këto të dhëna do të botohen vetëm bashkërisht dhe nuk do të përdoren për të marrë ndonjë vendim administrativ, duke përfshirë këtu vendime për kontrollin fiskal ose hetime juridike.</p>
<p>11.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave</p>	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijojnë paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p> <p>Nga të dhënat në nivel individual të RB largohen të gjitha të dhënat demografike të ndërmarrjes, si Nipt-i, emri i ndërmarrjes, emri dhe mbiemri i presidentit, data e krijimit të ndërmarrjes dhe adresa e saj. Fillimisht shënjohet me (c) si konfidenciale rastet e grupimeve që kanë 3 ose më pak ndërmarrje si edhe rastet kur përqindja që zënë dy ndërmarrjet më të mëdha kalon 75%. Më pas shënjohen me (c) rastet të cilat do të çonin në identifikimin indirekt të ndërmarrjeve.</p>
<p>12. Komente</p>	
<p>Aneks</p>	